



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 31 gusht 2015  
Nr. ref.: RK 830/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin nr. KI14/15**

Parashtrues

**Milić Krstić**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës,  
GSK-KPA-A-284/13, të 2 dhjetorit 2014**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Milić Krstić, me vendbanim në Mitrovicë të Sremit, Republika e Serbisë (në tekstin e më tejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati z. Goran Belić.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës - Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i AKP-së), GSK-KPA-A-284/13, të 2 dhjetorit 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [GSK-KPA-A-284/13] të Kolegjit të Apelit të AKP-së, të 2 dhjetorit 2014, me të cilin pretendohet të jetë shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Kosovës.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 11 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 mars 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI14/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH. KI14/15, Kryetari i Gjykatës caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 27 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit të AKP-së për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI14/15 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Arta Rama – Hajrizi. Me Vendim të njëjtë, Kryetarja caktoi gjyqtaren Arta Rama – Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit më 26 qershor 2015 i përfundoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 6 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, më 8 shtator 1998, organi administrativ i Komunës së Istogut nxori aktvendimin për dhënie në shfrytëzim të ngastrës nr. 1800/2, në të cilën ai më vonë ndërtoi një objekt afarist, i cili është objekt i çështjes i kësaj ankese kushtetuese.

11. Më 6 korrik 2007, parashtruesi parashtroi kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkoi vërtetimin e të drejtave pronësore mbi objektin afarist që gjendet në rrugën “Varoshi”, komuna e Istogut, ngastra nr. 1800/2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 48 m<sup>2</sup>.

12. Më 18 prill 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nxori vendim [KPCC/D/C/200/2013], me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën pronësore të parashtruesit. Në përfundimin e vendimit thuhet:

*“[...] Sekretariati Ekzekutiv i KKPK-së nuk e ka vërtetuar besueshmërinë e dokumenteve të dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës. Komisioni gjen se paraqitësi i kërkesës nuk e ka dëshmuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën në kërkesë”.*

13. Më 6 shtator 2013, parashtruesi parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së ndaj vendimit KPCC/D/C/200/2013 të KKPK, të 18 prillit 2013.

14. Më 2 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit i AKP-së nxori Aktgjykim [GSK-KPA-A-284/13], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi në tërësi vendimin e KKPK-së [KPCC/D/C/200/2013], të 18 prillit 2013.

15. Në përfundimin e vendimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së, të 2 dhjetorit 2014, thuhet:

*“[...] ankuesi (parashtruesi i kërkesës) nuk ka sjellë ndonjë vendim për ndarje ose provë e cila e vërteton të drejtën për përdorim ose të drejtën e pronësisë mbi hapësirën afariste pavarësisht nga fakti që komisioni ka kërkuar shpjegime dhe informata plotësuese, dhe në pajtim me këtë, Kolegji i Apelit i AKP-së gjen se KKPK-ja nxori vendim të saktë, të bazuar në procedurën e plotë dhe të saktë. Kolegji i Apelit i AKP-së mëtej gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale ose vërtetim jo të plotë të fakteve, prandaj ankesa është e pabazuar”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

16. Parashtruesi thekson në kërkesë se gjykatat kanë shkelur të drejtën materiale dhe kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike lidhur me kërkesën e tij për vërtetimin e së drejtës pronësore.

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

*„[...] Gjykata të vërtetojë se në procedurën në Gjykatën Supreme të Kosovës – Kolegjin e Apelit të AKP-së në lëndën me nr. GSK-KPA-A-284/13 është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e pronës nga neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të përcaktojë mënyrën e shpërblimit të drejtë të parashtruesit të ankesës kushtetuese, gjegjësisht, ta urdhërojë Gjykatën Supreme të Kosovës – Kolegjin e Apelit të AKP-së që përsëri të vendosë sipas ankesës.”*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

19. Në këtë kuptim, neni 113, par. 7, i Kushtetutës parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

20. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendohet se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*(d) nëse kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.*

22. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është e mbështetur posaçërisht në pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës]. Ky nen parasheh:

- 1. “E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
- 4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
- 5. Prona intelektuale mbrohet me ligj”.*

23. Gjykata vëren më tutje se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, të cilin e thekson në kërkesë, me asgjë tjetër nuk e arsyeton pretendimin e vet para Gjykatës.

24. Gjykata thekson se e drejta e pronës nga neni 46 i Kushtetutës është objekt i mbrojtjes në sistemin kushtetues të Kosovës dhe korrespondon në përmbajtje me të drejtën e pronës, të paraparë me nenin 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Këtë të drejtë e mbron Kushtetuta, duke ua ndaluar organeve të pushtetit shtetëror kufizimet ose heqjen e kësaj të drejte, përveç nëse kufizimi ose heqja e saj mbështetet në ligj.
25. Sipas mendimit të Gjykatës, vetë fakti që parashtruesi i kërkesës e ka humbur kontestin në çështjen juridike të vërtetimit të së drejtës pronësore nuk mjafton për t'u konstatuar shkelja e së drejtës së tij e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nëse ai nuk provon që me vendim gjyqësor të jetë privuar në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë nga prona (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
26. Gjykata përsërit më tej se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të marra nga ana e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih edhe rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
27. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar që me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ.
28. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 gusht 2015, njëzëri

### VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Ivan Čukalović



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Jeta Rama-Hajrizi